



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Numri i lëndës: 2024:117052  
Datë: 24.09.2024  
Numri i dokumentit: 06203767

**K.DH.SH.II.nr.810/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës (TEIP), Prishtinë, kundër debitorit NGB “Z...” SH.P.K., me NRB: ..., me seli në Prishtinë, rruga “...” p.n, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.849/23 të datës 26.09.2023, me datën 20.09.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e debitorit NGB “Z...” SH.P.K., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.849/23 të datës 26.09.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.849/23 të datës 26.09.2023, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit NGB “Z...” SH.P.K., i paraqitur kundër urdhrorit përmbartimor P.nr.97/2023 të datës 15.05.2023, të Përmbartuesit Privat Driton Govori.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljës së dispozitave të procedurës përmbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.97/23 të datës 15.05.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues Vendimit të Inspektoratit të Punës në Kosovë me numër 01Nr.09-131-V484/2022 të datës 20.10.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që nga dita e pranimit të këtij urdhri t'i paguaj kreditorit në emër të masës ndëshkimore shumë në vlerë prej 4,100.00 €, në të kundërtën përmbarimi të realizohet përmes ndalimit të mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë e tij bankare dhe bartjes së shumës së lartcekur në llogarinë e përmbaruesit privat, si dhe është obliguar debitori që të paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore sipas Udhëzimit Administrativ MD.NR.01/2022 për tarifatat dhe kompensimin e shpenzimeve të përmbaruesit privat.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se kundër Aktvendimit me numër 01.NR.09-131-V-484/2022 të datës 20.10.2022 në bazë të së cilit është lejuar përmbarimi, debitori ka ushtruar ankesë pranë Inspektoratit të Punës si organ i shkallës së dytë për mos vërtetim të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të ligjit nga organi i shkallës së parë. Ka deklaruar se me Vendimin e Inspektoratit të Punës së shkallës së dytë me numër të protokollit 145 të datës 12.04.2023 i është refuzuar ankesa si e pabazuar dhe nuk janë trajtuar pretendimet ankimore të debitorit dhe se gjoha e shqiptuar është krejt paushalle dhe e pa arsyetuar. Ka shtuar se, ekzekutimi i urdhrit përmbarimor do t'i shkaktonte dëm të konsiderueshëm financiar si pasojë e neglizhencës së kreditorit në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike me rastin e shqiptimit të

gjobës. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj prapësimin e debitorit dhe Urdhri përmbarimor P.nr.97/2023 i datës 15.05.2023 të anulohet në tërësi.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se propozimi për përmbarim është parashtruar si rezultat i mos pagesës së detyrimeve të debitorit në mënyrë vullnetare për pagesën e gjobës së shqiptuar të vendimit të formës së prerë nga Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës. Ka kundërshtuar pretendimin e debitorit se propozimi për përmbarim duhet të ndërpritet për shkak të mungesës së bazës juridike për përmbarim dhe për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike nga ana e inspektorëve të punës. Tutje ka shtuar se, vendimet e TEIP janë të ekzekutueshme dhe ushtrimi i padisë në konflikt administrativ nuk e ndalë ekzekutimin e vendimit, andaj gjykatës i ka propozuar që të refuzoj prapësimin e debitorit dhe të mbetet në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.97/2023 i datës 15.05.2023.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar pas vlerësimit të prapësimin ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.849/23 të datës 26.09.2023, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit NGB “Z...” SH.P.K., i paraqitur kundër urdhrit përmbarimor P.nr.97/2023 të datës 15.05.2023, të Përmbaruesit Privat Driton Govori. Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar në rastin konkret dokumentin përmbarimor Vendimin e Inspektoratit të Punës në Kosovë me numër 01NR.09-131-V-484/2022 të datës 20.10.2022, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafit 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrit të përmbaruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori.

Kjo gjykatë vlerëson se Vendimi i Inspektoratit të Punës në Kosovë me numër 01NR.09-131-V-484/2022 të datës 20.10.2022, është dokument përmbarues dhe i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “ *Dokument*

*përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (me tej: ujdia)*” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu është në pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 të LPP i cili përcakton se: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit ”*, ndërsa një dokument përmbarimor për të shërbyer si titull përmbarues patjetër duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbarimor. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbarimor të papërshtatshëm për përmbarim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se Vendimi i Inspektoratit të Punës në Kosovë me numër 01NR.09-131-V-484/2022 të datës 20.10.2022, është dokument i përmbarueshëm dhe i cili vendim përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë të datës 12.04.2023, ashtu që si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se *“ Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri ”*, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se *“ Vërtetimin për përmbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë ”*. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbarim.

Gjykata mori parasysh pretendimet ankimore të debitorit, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara ngase Vendimi i Inspektoratit të Punës në Kosovë me numër 01NR.09-131-V-484/2022 i datës 20.10.2022, përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë të datës 12.04.2023, andaj i plotëson kushtet për caktimin e përmbarimit në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkalles se Dytë  
K.DH.SH.II nr.810/24, me datë 20.09.2024

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija Ymeri